

DREJTORIA E ARSIMIT

05nr. 950 datë 27.09.2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212 , nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032 , nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068 , UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. Gjimnazi "Jeta e re" Suharekë

- Një mësimdhënës për lëndën e TIK-ut deri më datë 31.08.2019.
- Një mësimdhënës për lëndën e edukatës qytetare (deri në përfundimin e mandatit të zv.drejtorit të shkollës)

2. SHFMU "Drita"-Gelancë

- Një mësimdhënës të mësimit klasor (zëvendësim i pushimit të lehonisë)

3. SHFMU "Migjeni"-Gjinoc

- Një mësimdhënës të mësimit klasor

Kushtet:-Për vendet e lira të punës të shpallura në konkurs për mësimdhënës kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.10/2018.

4. SHFMU "Hasan Prishtina"-Semetisht

- Një punëtor ndihmës -rishpallje

5. IP "Fluturat"-Suharekë

- Një punëtor ndihmës për paralelen e ndarë në Mushtisht

Kualifikimi për punëtor ndihmës : Shkolla fillore

Paga(koeficienti): 4

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit(kërkesa)të cilën e plotëson kandidati
- Diplomat e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj(fotokopje).
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës(nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës.

Afati i konkurimit 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.

Për orarin e mbajtjes së intervistave do të njoftoheni përmes njoftimit të publikuar në web faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve në DKA.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bytyqi


